



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 65, DATË 21.08.2020

PËR  
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SUBJEKTIT PERSON FIZIK SHPRESA BORIÇI  
PËR RINOVIMIN E AUTORIZIMIT PËR PËRSËRITJEN E SHËRBIMIT TË  
PROGRAMIT AUDIOVIZIV TË TË TRETËVE MBËSHTETUR NË RRJET  
KABLLOR “TV KABLLOR TËRBUF”

Në mbështetje të nenit 19, pika 1/b, nenit 55, pika 4/b të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017, si dhe pas shqyrtimit të aplikimit nr. 1325 prot., datë 28.05.2020, të subjektit person fizik Shpresa Boriçi, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Shpresa Boriçi, me NIPT K747014010, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Tërbuf”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
2. Kushtet e autorizimit të subjektit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Tërbuf”, mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet prej datës 04.06.2020.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtarë:	Agron	GJEKMARKAJ
	Gledis	GJIPALI
	Suela	MUSTA